



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 160 datë 07.12.2020

**“PËR
PËRCAKTIMIN E VLERAVE PËR PËRFITUESIT E GRANTIT TË
RIKONSTRUKSIONIT/RINDËRTIMIT, BANESAT E TË CILËVE JANË
KLASIFIKUAR NGA AKTEKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSTITUTIT TË
NDËRTIMIT ME NIVEL DËMESH DS4 DHE DS5”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, vendimit nr. 887, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, për vitin 2016”, vendimit nr. 157, datë 27.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, të ndryshuar, Memos me nr. 42597 prot, datë 03.12.2020, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga Aktekspertizat e thelluara të Insitutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS5, sipas tabelës së mëposhtme:

Përbërja familjare	Struktura e banesës	Vlera e grantit të rindërtimit
Deri në 2 anëtarë	1+1	2100000 (dy milionë e njëqind mijë) lekë
2 deri në 4 anëtarë	2+1	2500000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë
5 e më shumë anëtarë	3+1	2800000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë

2. Përfitojnë vlerën e plotë të rikonstruksionit sipas preventivit të paraqitur, individët ose familjet shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve janë klasifikuar nga aktekspertizat e thelluara të Insitutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS4, por në çdo rast jo më shumë se 70 përqind të vlerës prej:

a. 2100000 (dy milionë e njëqind mijë) lekë për banesat 1+1;

b. 2500000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë për banesat 2+1;

c. 2800000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë për banesat 3+1 ose më shumë.

3. Shuma e grantit të rindërtimit/rikonstruksionit shpërndahet në dy këste: kësti i parë, në masën 60 % të vlerës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës depozitohet në llogarinë e Postës Shqiptare. Tërheqja e fondit nga subjekti përfitues do të bëhet në momentin e depozitimit të aktit të miratimit të kërkesës për leje ndërtimi për lejimin e punimeve përkatëse. Pjesa e mbetur e shumës, për grantin e rindërtimit lëvrohet pas verifikimit nga struktura e përkatëse e mbikqyrjes së kontratës që subjekti përfitues ka përfunduar ndërtimin e karabinasë së objektit në përputhje me dokumentet e lejes së ndërtimit. Për grantin e rikonstruksionit, kjo shumë kalon pas depozitimit të projektit të rikonstruksionit ose listës së punimeve të riparimit dhe preventivit të punimeve që kërkohen të financohen, hartuar nga projektues të licencuar dhe e konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

4. Brenda një muaji nga data e nënshkrimit të kontratës së grantit, subjekti përfitues duhet të depozitojë projektin e rikonstruksionit ose listën e punimeve të riparimit dhe preventivit të punimeve që kërkohen të financohen, hartuar nga projektues të licencuar. Dokumentacioni i depozituar sipas kësaj pike bëhet pjesë e dosjes së aplikimit për përfitimin e grantit.

5. Në rast se pas dorëzimit të projektit model të realizuar nga vetë subjekti që kërkon përfitimin e grantit të rindërtimit, ose projektit të rikonstruksionit apo listës së punimeve të riparimit dhe preventivit të punimeve për grantin e rikonstruksionit, konstatohet se vlera e përgjithshme e tyre është më e madhe se vlera e përlllogaritur sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, përfituesit i akordohet vlera që rezulton nga zbatimi i këtyre të fundit.

6. Komisioni i posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programet e procesit të rindërtimit, i ngritur me urdhrin nr. 11408/1, datë 25.3.2020, të kryetarit të Bashkisë, në përmbushje të detyrës për propozimin e përfituesve dhe vlerave përkatëse të rikonstruksionit, merr si referencë kufijtë minimalë dhe maksimalë të shumave të grantit, të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi.

7. Procedura e detajuar në lidhje me shqyrtimin e projektit të rikonstruksionit ose listës së punimeve të riparimit dhe preventivit të punimeve që do të depozitohen nga aplikuesit përfitues të grantit të rikonstruksionit, miratohet nga kryetari i Bashkisë, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Miratimin e kontratës tip për përfitimin nga granti i rindërtimit/rikonstruksionit për individët ose familjet, sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, e cila përmban minimalisht elementët si: afatet që parashikohen në lejet përkatëse të ndërtimit si dhe penaltetet në rastet e mospërmbushjes së detyrimit, që përfshijnë por nuk kufizohen edhe në kthimin e grantit kur konstatohen abuzime nga përfituesi, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për këto kontrata.

9. Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ndjekin procedurat e përshpejtuara për shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi, sipas parashikimeve të vendimit nr. 887, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave.

10. Mbikqyrja e zbatimit të kontratës nga përfituesi të kryhet nga strukturat përkatëse të përcaktuara me urdhër të kryetarit të Bashkisë Tiranë. Struktura e mbikqyrjes së zbatimit të kontratës së grantit përmbush ato funksione që ngarkohen në urdhrin e kryetarit dhe kontratën e grantit.

11. Ngarkohet kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij, për nënshkrimin e kontratës përkatëse të grantit, e cila përmban minimalisht parashikimet e modelit tip, të përcaktuar në pikën 9, të këtij vendimi.

12. Njësitë administrative/lagjet e Bashkisë Tiranë, përpara nënshkrimit të kontratës përkatëse, të marrin masat e nevojshme për njoftimin e aplikantëve përfitues të grantit të rikonstruksionit për dorëzimin e planimetrisë përkatëse të hartuar nga projektues të licencuar, e cila i bashkëlidhet kontratës përkatëse, dhe ku të jetë identifikuar qartë struktura e banesës së dëmtuar, përkatësisht 1+1; 2+1 dhe 3+1 ose më shumë, si dhe dorëzimin e të dhënave bankare për përfituesit e grantit të rikonstruksionit/rindërtimit.

13. Procedurat e parashikuara në këtë vendim mund të zbatohen edhe për aplikuesit e shpallur përfitues të grantit të rindërtimit me vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak, për të cilët nuk ka filluar ende procesi i ndërtimit të banesave të reja.

14. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, komisioni i posacëm, njësitë administrative dhe lagjet e Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R E

ROMINA KUKO